



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Datë: 30.12.2024

Përmbledhje e të arriturve të Ministrisë së Zhvillimit Rjonal për vitin 2024

I. Programi për Zhvillim Rajonal i Balancuar (Investimet kapitale) dhe Përkrahja e Bizneseve dhe Shoqërisë Civile

1. MZHR gjatë vitit 2024 ka financuar 21 projekte në 20 komuna në vlerë prej 2,671,580.97 euro të cilat kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik.
2. MZHR gjatë vitit 2024 ka financuar 189 projekte të bizneseve fillestare (startup dhe bizneseve ekzistuese në shtatë rajonet zhvillimore në vlerë prej rreth 2.6 milion euro.
3. Vlen të theksoet se këtë vit MZHR ka financuar edhe një kategori të veçantë bizneset zejtare dhe artizanale ku nga kjo skemë kanë përfituar rreth 12 biznese artizanale në vlerë prej rreth 20,000.00 euro.
4. Gjithashtu në përkrahje të shoqërisë civile e cila kontribuon në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal ka përkrahur 61 OJQ në vlerë prej 245,000.00 euro.

Figura 1. Shpërndarjen e investimeve financiare për secilën kategori për vitin 2024





Figura 2. Grafiku që paraqet përqindjen e investimeve financiare për secilën kategori për vitin 2024

Përqindja e Investimeve Financiare sipas Kategorive 2024



II. Kompletmi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal

Janë finalizuar dhe miratuar 4 rregullore që derivojnë nga Ligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar:

- Rregullore për menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
- Rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore;
- Rregullore për standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për zhvillim rajonal të rajonave zhvillimore;
- Rregullore për Performance rajonale dhe monitorim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar.

III. Hartimi i Dokumenteve Strategjike dhe analizave për Zhvillim Socio-ekonomik rajonal të balancuar

Janë përfunduar dhe publikuar 3 dokumente që kanë të bëjnë me pasqyrimin e resurseve sipas shtatë rajoneve zhvillimore:

- Pasqyrim i resurseve ekonomike;
- Pasqyrimi i resurseve kulturore;
- Pasqyrimi i resurseve natyrore.

Është finalizuar dhe publikuar analiza e investimeve kapitale për shtatë rajonet zhvillimore për vitin 2023:

Figura 3. Shpërndarja e investimeve kapitale në rajone zhvillimore vitin 2023





Figura 4. Investimet kapitale për kokë banori nga totali i projekteve të definuara dhe padefinuara në rajone zhvillimore (komuna)



Është finalizuar dhe publikuar analiza e përkrahjes së sektorit privat për shtatë rajonet zhvillimore për vitin 2023.

IV. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar dhe realizimi i konferencave për Zhvillim Rajonal

- Në vitin 2024 MZHR në bashkëpunim me Institutin IKSZ organizon konferencën ndërkombëtare shkencore për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal më datë 10-11.10.2024;
- Ëhtë finalizuar draft marrëveshja e bashkëpunimit me GIZ që parasheh një bashkëpunim 3 vjeçar MZHR-GIZ;
- Është konfirmuar nga GIZ një projekt i bashkëpunimit me MZHR në vlerë prej 1 mil euro për përkrahje të grave në biznes;
- Bashkëpunimi me UN-Habitat, organizimi i konferencës “Të bëhemi kreativ për zhvillim rajonal”;
- Në bashkëpunim me Caritasin Zviceran janë përfunduar dy projektet.

MARDI

- 6 projekte investuese të diaspores në bashkëpunim me bizneset e kosovës;
- 5,614 përfitues indirekt nga projekti;
- 1,830 përfitues direkt;
- 797 persona të riatdhesuar dhe refugjatë që janë përfshirë në programe të arsimit bazë dhe programe të tjera trajnimi;

- Mbështetja e 13 trajnimeve mbi programet e zhvillimit të kapaciteteve në mbështetjen psikosociale dhe të drejtat e njeriut për 300 zyrtarë të përzgjedhur qeveritarë të linjës së parë;
- 162 persona të riatdhesuar dhe refugjatë që kanë marrë shërbime emergjente mbështetje psikosociale dhe referime;
- 129 persona të riatdhesuar dhe refugjatë që kanë raportuar rritje të të ardhurave në zinxhirët jo-bujqësorë të vlerës;
- 679 persona të riatdhesuar dhe refugjatët që kanë marrë pjesë në një trajnim formal mbi aftësitë e jetës, AAPT-në dhe punësueshmërinë.

YENI

- Realizimi i 66 projekteve në 60 shkolla të mesme në 17 komuna, dhe themelimi i 60 eko klubeve në shkollat e mesme;
- Realizimi i 32 trajnimeve në 4 module për ndryshimet klimatike;
- Katër tekste mësimore të zhvilluara për ndryshimin e klimës dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Organizimi i 22 trajnimeve për nxënësit e 60 shkollave në 17 komuna dhe 16 punëtorive Climate Fresk, ku janë trajnuar 480 anëtarë të eko klubeve;
- Zhvillimi i 60 planeve mjedisore për shkolla dhe 72 buletineve mjedisore.

V. Ku ishim ku jemi:

Gjendja e mëparshme	Gjendja e tanishme
Republika e Kosovës pa rajone statistikore dhe rajone zhvillimore të definuara sipas standardeve evropiane.	7 rajonet statistikore të definuara sipas standardeve të EUROSTAT dhe 7 rajonet zhvillimore të definuara në përputhje me rajonet statistikore një mundësi e mirë për përfitim nga fondet e BE-së.
Mungesë e korinzës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar.	Ligji për zhvillim rajonal i balancuar i miratuar dhe katër aktet nëligjore që derivojnë nga ky ligj të miratuara.
Mungesë e analizave socio-ekonomike rajonale.	Përgaditja dhe publikimi i dy 2 analizave vjetore për zhvillim rajonal për investime kapitale dhe përkrahje të sektorit privat sipas rajoneve zhvillimore.
Nga vitin 2021-23, ishin 56 projekte të përkrahura për zhvillimin e infrastrukturës për zhvillim socio-ekonomik në vlerë prej 5.7 milion euro.	Në vitin 2024 janë 21 projekte në 20 komuna në vlerë prej 2,671,580.97 euro, që arrijnë shumën gati 50% çka është investuar për 3 vitet e kaluara.

Nga vitin 2021-23, ishin 709 projekte të përkrahjes së bizneseve në vlerë prej 6.87 milion euro.	Në vitin 2024 janë 201 projekte për 201 biznese përfshirë edhe bizneset zejtare dhe artizanale në vlerë prej 2,6 milion euro, që e rrit numrin e përkrahjes së bizneseve si dhe rreth 400 të punësuar të rinj në vitin 2024.
Mungesë e aktiviteteve me partner ndërkombëtarë.	- Realizimi i dy projekteve me Caritasin Zviceran; - Përkrahja nga GIZ për hartimin e legjislacionit sekondar; - Arritja e përkrahjes së re nga GIZ në vlerë prej 1 milion euro për përkrahje të granteve në ndërmarrësi; - Finalizim i marrëveshjes së bashkëpunimit me GIZ për periudhën e ardhshme 3 vjeçare për përkrahje të MZHR-së, komunave dhe bizneseve.
Mungesë e realizimit të konferencave për fushën e zhvillimit sioc-ekonomik rajonal.	- Realizimi i konferencës së parë për zhvillim rajonal me vendet e ballkanit përendimor e më gjerë dhe vendet tjera të BE-së; - Në vitin 2024 MZHR në bashkëpunim me Institutin IKSZ organizon konferencën ndërkombëtare shkencore për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal më datë 10-11.10.2024. - Realizimi i “Forumit të Zhvillimit Rajonal Kosovë-Shqipëri” ku qëllimi kryesor ka qenë shfrytëzimi i lidhjeve të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në kontekstin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal. - Bashkëpunimi me UN-Habitat, organizimi i konferencës “Të bëhemi kreativ për zhvillim rajonal”.